



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data/Date:	18.06.2024
Nga/Od/From	Grupi punues
Për/Za/To:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
CC	Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit
Tema/Subjekat/Subject	Raporti me (komente) për organizimin e konsultimit publik për Qarkoren e Pare Buxhetore 2025/1 dhe KAB-in 2025-2027, konsultimi publik organizohet nga kryetari i Komunës, Shaqir Totaj

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

-Me 19.01.2024, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027, si dhe Projekt-Buxheti i Komunës së Prizrenit për vitin 2025, anëtar të grupit punues janë: Zenel Ahmetaj, anëtarë; Halil Lika, anëtarë; Gjafer Poniku, anëtarë; Fejsal Hoti, anëtarë; Naim Kukaj, anëtarë; Ymer Berisha, anëtarë dhe Haziz Krasniqi, anëtarë.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **03.06.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/06/NJOFTI1.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/sk7qwxWYd8w5cS2H/?mibextid=oFDknk>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42442>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-qarkoren-e-pare-buxhetore-dhe-kab-in-2025-2027-i-organizuar-nga-kryetari-i-komunes-shaqir-totaj/>

Me **03.06.2024**, njoftimi (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me **13.06.2024**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-qarkoren-e-pare-buxhetore-2025-01-dhe-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2025-2027/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/XeBi1tPWTJpdLS58/?mibextid=oFDknk>

14.06.2024, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/06/Procesverbali-per-konsultimin-publik-per-KAB-Kryetari-Shaqir-Totaj-PDF-SCAN.pdf>

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultimeve publike, nga data **03.06.2024** deri me **17.06.2024**, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë **17.06.2024**.

Përmes formës elektronike është pranuar 1 koment, 46 komente janë pranuar gjatë konsultimit publik, kurse asnjë koment nuk është pranuar në formë fizike.

Video e mbajtjes së konsultimit:

<https://www.facebook.com/share/v/pcQ3nvt3ddhaKKU6/?mibextid=oFDknk>

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Konsultimi publik për Qarkoren e Pare Buxhetore 2025/1 dhe KAB-in 2025-2027, konsultimi publik organizohet nga kryetari i Komunës, Shaqir Totaj	13.06.2024 Nga-10:10 Deri-12:13	F M T 1 22 23	14	46 8-Pjesërisht 2-Refuzohen 35-Pranuar

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/sugjerim	Statusi i kërkesës /sugjerimi i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
1	1-Kanalizim , Trotuari nga fshati Krajk deri në fshatin Bregdrini	Marte Prekpalaj kryetare e këshillit të fshatrave Zym, Bregdrini, Karashengjergj (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	Komuna përmes drejtorisë së Shërbimeve Publike, do të bëjë rregullimin e trotuareve me kontratat ekzistuese si dhe me kontratat e reja që do të lidhen në vazhdimësi.
	2-Ndertimi i Shkolles ne fshatin Zym		Pjesërisht	Jemi duke analizuar numrin e nxënësve, trendin e rritjes apo zvogëlimit të tyre dhe cilët janë nevojat reale për hapësirë të reja shkollor në këtë fshat.
	3-Uje te pijes (Problem ne tre fshatrat)		Pranohet	Edhe pse kompania e ujerave nuk është nën menaxhimin e komunës, komuna për vitet 2025-2027 do të ka të ndarë mjete buxhetore për përmirësimin rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.
	4-Projekt per mbrojtjen e mjedisit		Pranohet	Në kuadër të projekteve që do të hartojnë drejtoritë si ajo e Urbanizmit dhe ajo e Shërbimeve publike do të planifikojnë edhe projekte që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit.
	5-Qender rekreative, shteg per peshkatar		Pranohet	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të planifikoj projekte dhe buxhet për të tilla projekte.
2	1-KOJUSHE-Rruge locale, Kanalizim, Ndriqim public, rregullim I rruges te hyrja e shkolles ne fshati Koujshe	Shani Tanaj, kryetar i fshatrave Mazrek , Milaj, Gorozhup (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	Komuna përmes drejtorisë së Shërbimeve Publike (DSHP), do të planifikoj buxhet dhe projekt për rregullimin e rrugëve si në fshatin Planej, gjithashtu edhe në fshatra tjerë
	2-PLANEJE- Rruge lokale, kanalizim, riparim i shkolles		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për rregullimin e rrugës.

	3-MAZREK- Rruge lokale , Trotuar nga fsh Mazrek deri tek fsh. Kojushe, ndriqim publik, pastrmi i rrugeve, ndertimi i Ambulates		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për rregullimin e trotuarit dhe ndriçimit publik.
3	1-Ndertimi i nje aneksi te shkolles	Besim Nerjovaj, kryetar i fshatrave Lubizhde, Dedaj (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pjesërisht	Jemi duke analizuar numrin e nxënëseve, trendin e rritjes apo zvogëlimit të tyre dhe cilët janë nevojat reale për hapësirë të reja shkollor enë këtë fshat.
	2-Betonimi i perrockes se fshatit		Pranohet	Përmes DSHP-së, është planifikuar në KAB, për realizimin e këtij projekti.
	3-Fushe te sportit ne Dedaj		Pranohet	DKRS, do të planifikoj buxhet për realizimin e këtij projekti.
4	1-Rregullimi i nje shtrese tjeter te asfaltit ngase rruga eshte shume e demtuar	Engjëll Kajtazi, fshati Karashengjergj (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	Përmes DSHP-së, është planifikuar në KAB, për realizimin e këtij projekti.
	1-Rruga Gorozhup-Pashtrik		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për vitet në vazhdim për realizimin e këtij projekti.
5	2-Impiant ne fshatin Tupec-Nashec	SHUKRI QUNI: kryetar i fshatrave Nashec, Grazhdanik (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pjesërisht	Komuna planifikon të bëjë studimin e fizibilitetit për rregullimin e këtij impianti.
	3-Impiant qe derdhen tek vikendicat ne Nashec		Pjesërisht	Komuna planifikon të bëjë studimin e fizibilitetit për rregullimin e këtij impianti.
	4-Impiant Kojushe, Mazrek Gorozhup		Pjesërisht	Komuna planifikon të bëjë studimin e fizibilitetit për rregullimin e këtij impianti.
	5-Kanalizim		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për vitet në vazhdim për realizimin e këtij projekti.
	6-Salle ne shkollen Luigj Gurakuqi ne Nashec		Pranohet	DKRS, do të planifikoj buxhet për realizimin e këtij projekti.
6	1-Rruga e staneve ne fsh. Vermice	BUJAR PULAJ: kryetar i fshatrave Vermice Shkoze Dobrushte (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	DSHP, do të planifikoj realizimin e këtij projekti dhe do të hy në projeksione buxhetore (KAB).
	2-Ndriqimi publik ne fsh.Vermice dhe fshati Dobrushte		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për vitet në vazhdim për realizimin e këtij projekti.
7	1-Rregullim i rruges ne fsh. Lubizhde	DASHNOR VEHAPI kryetar i fshatrave Lubizhde, Skorobishte Gernqar (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	DSHP, do të planifikoj realizimin e këtij projekti dhe do të hy në projeksione buxhetore (KAB).
8	TUPEC	HEROLIND OSMANOLLAJ: kryetar i fshatrave Gjonaj, Tupec (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për vitet në vazhdim për realizimin e këtij projekti (KAB).
	1-Rruge lokale,		Pranohet	DSHP, do të planifikoj që këtë projekt të fus në KAB.
	2-Rregullimi i rruges deri tek vorrezat e fshatit		Pranohet	DSHP, do të planifikoj realizimin e këtij projekti dhe do të hy në projeksione buxhetore (KAB).

	3-Kanalizim			Këtë projekt DSHP do të planifikoj ta realizoj dhe të hy në KAB.
	4-Zgjerimi i rruges tek shkolla		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për vitet në vazhdim për realizimin e këtij projekti.
	5-Trotuar dhe mirembajtje te rrugeve		Pranohet	DSHP, do të planifikoj që këtë projekt të fus në KAB.
	6-Policet e shtrirë (pengesa në rrugë)		Refuzohet	Nuk lejohet të vendosen pengesa në rrugë.
	7-Uje per ujitje te futet ne fshat		Pranohet	Edhe pse kompania e ujerave nuk është nën menaxhimin e komunës, komuna në vazhdimësi ka bërë dhe vazhdo të bëjë përpjekje që të bëjë furnizimin e qytetarëve me ujë të pijes.
	GJONAJ			
	1-Rregullimi i rruges kryesore		Pjesërisht	Rruga në fjalë është rrugë regjinale dhe është nën mbikëqyrjen e ministrisë së infrastrukturës. Ne si komunë do të bisedojmë me ministrinë përkatëse dhe besojmë që do të rregullojmë rrugën.
	2-Kanalizim		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për realizimin e këtij projekti.
	3-Trotuar		Pranohet	Këtë projekt DSHP do të planifikoj ta realizoj dhe të hy në KAB.
	4-Pastrim i rrugeve		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për të tilla projekte.
	5-Mure anesore tek ura e fshatit dhe kodra e pajtimit		Pranohet	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoreshë, Emergjencia dhe Siguri (DES), do të planifikojnë buxhet për realizimin e këtij projekti.
	6-Intervenimi i ujrave te zeza ne tokat bujqesore		Pranohet	DSHP, do të planifikoj realizimin e këtij projekti dhe do të hy në projeksione buxhetore (KAB).
	7-Intervenimi i kanaleve te hapura si pasoje e vershimeve		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për të tilla projekte.
	8-Kerkese per punetor te Zyres se Gjendjes Civile		Pranohet	Komuna do të hartoj orar të ri për zyrtarin përgjegjës dhe besojmë që qytetarët do ti marrin shërbimet e tyre.
	9-Kerkese per stomatolog		Pjesërisht	Fillimisht do të analizohet nevoja për këtë shërbim nga ana e shëndetësisë primare-QKMF.
	10-Kerkese per 1 kamion per zjarrfikes		Pjesërisht	Stacioni i zjarrfikëseve ekziston, ndërsa për mjete për fikjen e zjarreve do të koordinohemi me brigadën e zjarrfikëseve në Prizren.
10	1-Trafa e rrymes tek shkolla e fsh. Kushnin	SMAJL SHATRI- fshati Kushnin , Kabash i Hasit (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Refuzohet	Nuk është në kompetencë të komunës.
	2-Kanalizim		Pranohet	DSHP, do të planifikoj buxhet për realizimin e këtij projekti.
	3-Furnizim me uje te pijes		Pranohet	Edhe pse kompania e ujerave nuk është nën menaxhimin e komunës, komuna në vazhdimësi ka bërë dhe vazhdo të

				bëjë përpjekje që të bëjë furnizimin e qytetarëve me ujë të pijes.
11	1-Uje te pijes	BESMIR SHALA: kryetar i fshatit Billushë (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	Edhe pse kompania e ujerave nuk është nën menaxhimin e komunës, komuna në vazhdimësi ka bërë dhe vazhdo të bëjë përpjekje që të bëjë furnizimin e qytetarëve me ujë të pijes.
	2-Mjeku te jete prezent në Ambulante.			Do të marrim masa adekuate për sigurimin e shërbimeve në fshatin Bellushë.
12	1-Mirembajtje dhe kontrole tek 4 ndertesat qe gjenden perballe gjimnazit Loyola	RUZHDI AJAZAJ: kryetar i fshatit Petrovë (koment i pranuar gjatë konsultimit)		Këto banesa u janë dhënë personave privat nga ana e komunës, vite më parë, sa i përket mjedisit rrethues të tyre, do të bisedojmë me sektorin e mirëmbajtjes së ambientit në nivel të komunës.
	Kanalizim i shkolles se fshatit		Pranohet	DSHP, do të planifikoj realizimin e këtij projekti dhe do të hy në projeksione buxhetore (KAB).
13	1-Te kete kontrole dhe organ mbikqyres ne punet te cilat zhvillohen ne fshat	GJOK KOLNREKAJ: fshati Karashengjergj (koment i pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	Komuna do të vazhdoj të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projekteve përmes kompanisë dhe zyrtarëve komunal
14	1-Kërkoj Perfshirjen e traznizit nga rrethi i hoqes ne lagjen bajram curri e deri ne arban ,pasi do te lehtsonte dukshem trafikun prej abi qarshis e deri te etc, pasi e dini qe eshte shume e ngarkuar , Si dhe ne baz te Planit te Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Prizrenin eshte rekomanduar: Rekomandohet projektimi dhe ndërtimi i qarkores së re, ku lidhet rruga nacionale N25 Prizren-Suharekë me rrugën nacionale N25 Prizren-Morinë. Përmes kësaj qarkoreje ndërlidhet tranziti i ri dhe krijohet vazhdimësi e tij, të përfunduar aktualisht nga komuna e Prizrenit, dhe njëherit të gjitha kërkesat për lëvizje tranzit nga zonat më të ngarkuar në hyrjet nga Suhareka dhe Gjakova mund të orientohen që ta shfrytëzojnë këtë qarkore dhe të shkarkojnë zonën qendrore të qytetit	Adil Kurtaj (koment i pranuar në formë elektorinike)	Pjesërisht	Komuna përmes Kuvendit Komunal e ka kaluar planin e mobilitetit dhe pas miratimit të planit do të shikohet se si dhe se çka është paraparë në atë pjesë të qytetit.

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Qarkores se Pare Buxhetore 2025/1 dhe KAB-in 2025-2027
2. „Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Raporti është përgatitur nga :

Haziz Krasniqi
